# DËSHMI ARKIVI

**A-411736**
VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Kreu i PD-së në SHBA, nis takimi i Berishës me shqiptarët e Amerikës në New Jersey - Bota Sot |
| ADRESA | `https://botasot.info/shqiperia/2525029/kreu-i-pd-se-ne-shba-nis-takimi-i-berishes-me-shqiptaret-e-amerikes-ne-new-jersey/` |
| BURIMI | botasot.info |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 6 shtator 2026, 16:31:47 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 600 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 6 shtator 2026, 16:26:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 6 shtator 2026, 16:25:00 UTC → 6 shtator 2026, 16:27:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `0e5d688066419c143590c8a49c2ff96d221d5b837c5f867729b8869dc1569c48` |
| TEKSTI | `327c0f31f396defabb1312d8df3b2357b61b42399695b2deb7e7d7c6ce82f207` |
| PAMJA | `1262aeb3224529cc170803c2817bf697863c1b1960a351ce4eb0acd2d72a8bac` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `cdac851a376ef9ab2efa9ccd0a7b13e2a49e7d9c487087d4accbae3e2ee2b4f5` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `af509d61787472ec8e41e2e6baaa0db3fd07d4af4f7a54c9293cb47ba3acab88` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/cdac851a376ef9ab2efa9ccd0a7b13e2a49e7d9c487087d4accbae3e2ee2b4f5`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

Kreu i PD-së në SHBA, nis takimi i Berishës me shqiptarët e Amerikës në New Jersey

- Lajme
- Kronikë
- Aktuale
- Politika
- Ekskluzive
- Sociale
- Historia
- Kuriozitete
- Bota
- Evropë
- Amerika
- Azia
- Sporti
- Futboll
- Basketboll
- Hendboll
- Volejboll
- Xhudo

**Shqipëria**

# Kreu i PD-së në SHBA, nis takimi i Berishës me shqiptarët e Amerikës në New Jersey

Më: 6 shtator 2026 Në ora: 18:26
Përditësuar në ora: 19:52 më 06.09.2026

Sali Berisha

Berisha nga SHBA: Rikthimin tim do ta përdor për forcimin e partneritetit me Amerikën “Misioni ynë është të çlirojmë Shqipërinë nga narkoshteti!”/ Berisha: Kam besim se SHBA do të na ndihmojë në betejën kundër narkoshtetit Berisha: Diaspora në Amerikë, zëri i pamposhtur i shqiptarëve në liri! Fati i bardhë i kombit shqiptar

06.09.2026 - 19:52

## Berisha nga SHBA: Rikthimin tim do ta përdor për forcimin e partneritetit me Amerikën

Gjatë takimit me shqiptarët në Shtetet e Bashkuara, kreu i Partisë Demokratike, Sali Berisha, foli për rikthimin e tij në SHBA dhe për marrëdhëniet që synon të ndërtojë me administratën amerikane nëse opozita vjen në pushtet.

Berisha deklaroi se rikthimin e tij do ta përdorë për forcimin e bashkëpunimit mes Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara, duke e cilësuar këtë marrëdhënie si të një rëndësie jetike për të ardhmen e vendit.

“Tani miq, le ta quajmë rikthim të dytë apo të tretë, le ta quajmë si të duam. Por një gjë ju siguroj, se ky rikthim do të përdoret për ndërtimin e një bashkëpunimi të shkëlqyer me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, i një rëndësie jetike për të ardhmen e vendit tonë”, deklaroi Berisha.

Ai vlerësoi rolin e SHBA-së në historinë e Shqipërisë, duke theksuar se shqiptarët nuk duhet të harrojnë kontributin amerikan në lirinë e vendit.

“Kurrë shqiptarët nuk duhet të harrojnë se ky vend ka kontributin më të madh se çdo vend tjetër i planetit në lirinë e botës”, u shpreh lideri i PD-së.

“Ky komb me qeveritë e tij kanë kontributin më të madh dhe përcaktues në lirinë e kombit shqiptar nga vitet ’20 të shekullit të kaluar deri në vitet 2000 të këtij shekulli”, tha ai.

“Do ta përdor, do ta përdorim së bashku, për ndërtimin e marrëdhënieve, të partneritetit më të shkëlqyer në interesin më të mirë të dy vendeve dhe kombeve tona, me këtë vend dhe qeverinë e Shteteve të Bashkuara”, deklaroi Berisha.

Në përfundim të fjalës së tij, kreu i Partisë Demokratike falënderoi diasporën shqiptare për pritjen dhe mbështetjen, duke e mbyllur fjalimin me një mesazh për shqiptarët dhe SHBA-në.

“Rroftë diaspora shqiptare! Rroftë kombi shqiptar! Rroftë kombi i madh amerikan! Zoti e bekoftë Shtetet e Bashkuara, Zoti e bekoftë Shqipërinë”, tha Berisha.

---

06.09.2026 - 19:20

## “Misioni ynë është të çlirojmë Shqipërinë nga narkoshteti!”/ Berisha: Kam besim se SHBA do të na ndihmojë në betejën kundër narkoshtetit

Në takimin me shqiptarët e Amerikës në New Jersey, lideri i opozitës, Sali Berisha, deklaroi se Partia Demokratike synon “ripërtëritjen e Shqipërisë”, duke e lidhur këtë objektiv me largimin e Edi Ramës nga pushteti.

*“Beteja jonë është për Shqipërinë”*, theksoi Berisha, ndërsa kërkoi mbështetjen e Shteteve të Bashkuara në përballjen që ai e cilësoi si betejë kundër “narkoshtetit”.

*“Nëse duam të ripërtërijmë Shqipërinë, kjo arrihet vetëm duke larguar nga pushteti Edi Ramën”*, tha Berisha, duke shtuar se opozita do ta fitojë, sipas tij, betejën për “dinjitetin kombëtar”.

*“Edi Ramën do ta largojmë nga qeveria dhe asgjë në botë nuk na ndal sot në këtë qëllim”*, u shpreh kreu i PD-së.

Berisha e cilësoi Shqipërinë si një “eksportues madhor droge” dhe deklaroi se lufta kundër asaj që ai e quan “narkoshtet” është një mision kombëtar, por edhe në interes të vendeve mike.

Duke iu referuar marrëdhënieve me SHBA-në, Berisha tha se ka besim se Shtetet e Bashkuara do ta mbështesin Shqipërinë në këtë betejë. Ai përmendi edhe vizitën e tij në SHBA në vitin 1991, kur, sipas tij, kishte kërkuar mbështetje për përmbysjen e diktaturës komuniste.

*“Sot, kërkesa ime ndaj vendit që i ka dhënë Shqipërisë dhe shqiptarëve një ndihmë të jashtëzakonshme është mbështetja për të shpëtuar nga narkoshteti i ndërtuar në trojet e tyre”*, tha Berisha.

Në fjalën e tij, lideri i opozitës foli edhe për familjen dhe politikat sociale, duke pretenduar se Shqipëria është shndërruar në një “kopsht eksperimental” të ideve të George Sorosit dhe “ekstremit të majtë”.

Berisha ngriti akuza edhe për politikat që lidhen me fëmijët, arsimin dhe familjen, duke deklaruar se, sipas tij, “në rrezik të madh është familja shqiptare”.

*“Beteja jonë është një betejë për ekzistencën e familjes shqiptare”*, përfundoi Berisha.

---

06.09.2026 - 18:27

## Berisha: Diaspora në Amerikë, zëri i pamposhtur i shqiptarëve në liri! Fati i bardhë i kombit shqiptar

Kryetari i PD-së Sali Berisha e nisi flajimin e tij para shqiptarëve të Amerikës duke shprehur mirënjohjen e pakufishme për pritjen vëllazërore.

Berisha tha se ‘kënaqësia ime e jashtëzakonshme ishte se po ju takoja ju, zëri I papmoshtur I shqiptarëve në liri”

Të dashur vëllezër, miq, shqiptaro- amerikanë.

Berisha: Përshëndetjet e mija më të përzemërta, mirënjohje më të pakufishme për këtë pritje vëllazërore. Kënaqësi më të madhe që unë takohem sot me ju. Me të njëjtin besim që kam pasur në mars të vitit 1991 në udhëtimin tim të parë në këtë vend të bekuar. Ai ishte një udhëtim më emocionali në jetën time. Emocionet vërshonin nga kënaqësia se unë po udhëtoja në drejtimin e duhur pas dekadash që vendi im kishte humbur drejtimin. Kënaqësia ime e jashtëzakonshme ishte se po ju takoja ju, zëri i pamposhtur i shqiptarëve në liri.

Berisha vijon fjalimin: Pata fatin e madh se takova atë plejadë të diasporës shqiptare e cila me atdhetarinë e saj me idealet demokratike e kombëtare dha një kontribut të jashtëzakonshëm në përmbysjen e diktarurës komuniste në Shqipëri dhe luftoi me të gjitha mjetet për lirinë e Kosovës.

Diaspora shqiptare në SHBA është fati i bardhë, fati i mirë i kombit shqiptar.

Takimi mbahet në sallën ‘Venetian Palace’ në New Jersey në SHBA.

## Lexo të radhës

Del jashtë kontrollit situata në Malin e Tërbunit, flakët vijojnë të përhapen me shpejtësi Situata me zjarret/ 20 vatra gjatë ditës, 11 prej tyre ende aktive, ja zonat më problematike Mediu: U përpoq një Amerikë ta bllokonte Berishën, i vetmi që është pritur dy herë në Shtëpinë e Bardhë
Fjalë kyçe New Jersey Sali Berisha

Të tjera nga Shqipëria
Nisma “Prania Besnike”, aktivisti: Rama ka shumëzuar me zero institucionet dhe ka krijuar partinë-shtet! Duhet ta shkulim me rrënjë
**Shqipëria**6 shtator 2026

### Nisma “Prania Besnike”, aktivisti: Rama ka shumëzuar me zero institucionet dhe ka krijuar partinë-shtet! Duhet ta shkulim me rrënjë

Në protestën e 99-të kundër qeverisë, një prej aktivistëve ka kritikuar ashpër ‘Praninë Besnike’, nisma e re e ndërmarrë nga qeveria, duke e akuzuar mazhorancën se ka zëvendësuar institucionet...

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.